



UNIVERSITETI I SHKODRËS "Luigj Gurakuqi"

SENATI

Nr. 256/ prot.

Shkodër, më 07. 07. 2016

V E N D I M

nr. 3/2, datë 07. 07. 2016

" PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR ANËTARË TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT"

Në mbështetje të nenit 38 pika, gj, nenit 48, pika 1 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Rektorit, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 06.07.2016

V E N D O S I:


1. Miratimin e kriterëve për anëtarë të Bordit të Administrimit përfaqësues të USH-së:
 - a. Të jetë pedagog me kohë të plotë në USH.
 - b. Të ketë të paktën gradën shkencore "Doktor".
 - c. Të mos jetë i zgjedhur si autoritet apo në organet drejtuese të USH-së.
 - d. Të mos jetë në ndjekje penale dhe ndaj tyre të mos jetë dhënë masë e sigurimit personal; të mos jetë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë, të mos jetë të dënuar më parë për vepra penale si dhe ndaj tyre të mos jetë dhënë masë disiplinore.
2. Ngarkohet Rektori për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Senatit


Prof. as. dr. Mirjam DIBRA

Kryetari i Senatit Akademik


Prof. dr. Adem BEKTESHI

